



Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme për klientët privat

Këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze. Ju mund të merrni një kopje në gjuhën e juaj të preferuar duke vizituar faqen tonë këtu.

Këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme zbatohen për të gjithë personat me të cilët OneFor Kosova hyn në marrëdhënie kontraktuale.

Efektive nga data: 01 Gusht 2023

Ne, OneFor Kosova SHPK (më tej referuar si "OneFor Kosova", "OneFor", dhe "Ne"), Institucion Financiar Jobankar, me numër 811480095, dhe adresë Rruga Tahir Zajmi 86, Prishtinë, përmes aplikacionit mobil (i referuar në tekst si "App OneFor") ofrojmë shërbime të ndryshme si: hapja të llogarisë për realizimin e pagesave elektronike, transfere, shërbime me kartelë (në tekst të referuara si "Shërbimet e OneFor").

1. Fushëveprimi i vlefshmërisë

Këto Kushte dhe Rregulla të Përgjithshme janë përgatitur në harmoni me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe vlejnë për të gjithë marrëdhënien e biznesit që ju do të lidhni, duke përfshirë por pa përjashtuar në përdorimin e OneFor (të gjithë përmbajtjen, funksionet, shërbimet dhe rregullat e tyre).

Këto kushte, së bashku me politikën tonë të privatësisë, politikën e ligjit të mbrojtjes së të dhënave, politikën e ankesave, politikën e ruajtjes së të dhënave dhe listën tonë zyrtare të çmimeve, përbëjnë një marrëveshje ligjore ndërmjet "Ju" dhe "Ne".

Duke u regjistruar në OneFor App apo duke përdorur shërbimet e OneFor, Ju i pranoni kushtet e kësaj kontrate dhe deklaroni se pajtoheni me to. Nëse Ne e çaktivizojmë llogarinë tuaj për shkelje të kushteve dhe rregullave tona, ju nuk do të mund krijoni një llogari tjetër pa lejen tonë.

Ju nuk mund të transferoni ndonjë nga të drejtat tuaja sipas kësaj marrëveshjeje, duke përfshirë çdo të drejtë për mjetet financiare që ne i mbajmë në llogarinë tuaj të OneFor, tek ndonjë person tjetër. Ju nuk mund të jepni ndonjë tarifë apo ndonjë siguri tjetër mbi çdo mjet financiar që Ne i mbajmë për Ju.

2. Definicionet

Para Elektronike: Vlera monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën

magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emetuesit, që emetohet pas pranimit të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet si mjet i pagesës nga personat tjerë përveç emetuesit të parasë elektronike.

Nënshkrimi elektronik: Grup i të dhënave në formë elektronike, të cilat janë të bashkangjitura ose të lidhura logjikisht me të dhënat e tjera në formë elektronike dhe të cilat përdoren nga nënshkruesi për të nënshkruar.

Transaksioni elektronik: Veprimtari afariste në mes të dy ose më shumë palëve, e cila kryhet përmes rrjeteve kompjuterike.

Urdhër pagesa: Urdhër nga paguesi, klienti ose marrësi tek OneFor për të ekzekutuar një transaksion pagese.

Konfirmimi i pagesës: Pas plotësimit të Urdhërpagesës përmes së cilit finalizohet transaksioni dhe i cili më pas ekzekutohet.

Fjalëkalimi: Kod i krijuar nga Klienti me rastin e hapjes së llogarisë apo ndryshimit të tij pas hapjes së llogarisë, për tu kyçur në llogari, për të iniciuar apo konfirmuar një urdhër pagesë, transaksion brenda apo jashtë OneFor.

ATM: Bankomat

POS: Pikat e shitjes

Push/SMS: Porosi të shkurtra ne telefon

BQK: Banka Qendrore e Kosovës

3. Përmbajtja e kontratës

Lënda e kësaj kontrate është përdorimi i Shërbimeve të OneFor. Ju do të keni të drejtë të përdorni OneFor App (aplikacionin) për të përdorur llogarinë, për të bërë pagesa elektronike, transferimin e mjeteve dhe shërbimet e kartelës të ofruara nga Ne në mënyrë digjitale. Tutje përmes kësaj kontrate ju i lejon OneFor për të marrë informata në lidhje me kartelën tuaj të OneFor, llogarinë në OneFor, dhe transaksionet e realizuara.

Ju mund të përdorni shërbimet e OneFor vetëm sa i përket shërbimeve të llogarisë për llogarinë tuaj në OneFor.

Kur ju të përdorni shërbimet e OneFor, informatat për llogarinë tuaj, kartelën dhe transaksionin transmetohen në formë të koduar.

Debit kartela (kartela e OneFor), llogaria e parasë elektronike atë dhe kuleta digjitale (llogaria e OneFor) është një produkt që ju ofrohet për Ju nga Ne.

Ne jemi të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës [NR. IFJB/082, DATA 17 NËNTOR 2022] për emetimin e parasë elektronike, transferim dhe pranim të parave, ose shërbimeve të pagesave për pagesa brenda dhe jashtë vendit.

Kartela juaj e OneFor do të jetë/lëshohet nga Ne me licencë nga MasterCard International. Mastercard është një markë tregtare e regjistruar dhe dizajni i rrethit është një markë tregtare e Mastercard International Incorporated.

4. Regjistrimi për shërbimet e OneFor; llogarisë së parasë elektronike në OneFor dhe aplikimi për kartelë

Ju do të keni nevojë për një telefon të mençur me qasje në Internet në mënyrë që të përdorni shërbimet e OneFor përmes App (aplikacionit) OneFor. Softueri operativ në telefonin tuaj të mençur po ashtu duhet t'i plotësojë disa kërkesa minimale. Këto kërkesa minimale janë specifikuar në faqen tonë të internetit këtu. Ne ruajmë të drejtën për të ndryshuar kërkesat minimale.

Ju do të duhet të shkarkoni OneFor App nga ofruesi i aplikacioneve tuaja mobile në mënyrë që të filloni regjistrimin, për të bërë një kontratë përdorimi me Ne për hapjen e një llogarie dhe përdorimin e debit kartelës. Pasi të keni instaluar OneFor App, Ju do të drejtoheni automatikisht në të gjithë hapat që duhet të ndërmerrni për t'u regjistruar dhe për të krijuar një lidhje midis telefonit mobil dhe OneFor App. Ju duhet t'i ofroni të gjitha të dhënat e kërkuara në mënyrë që të përfundoni regjistrimin. Ne do të verifikojmë adresën e postës elektronike dhe numrin e telefonit mobil që Ju na e ofroni Ne si pjesë e procesit të regjistrimit.

Ju duhet të pranoni kushtet dhe rregullat tona të përgjithshme, në mënyrë që të përfundoni procesin e regjistrimit. Përveq kësaj ju konfirmoni se nuk beni pjese ne listen e klienteve me te cilet nuk bashkepunojme. Pra, nuk jeni Person i Ekspozuar Politikisht (PEP) vetë dhe as nuk jeni pale e nderlidhur me PEP si dhe nuk jeni FATCA relevant.Një llogari mund të hapet vetëm pasi të jetë kryer një kontroll i identitetit nga një ofrues i jashtëmi shërbimeve. Identiteti juaj do të kontrollohet në distancë përmes video identifikimit.

Ju do të dërgoheni automatikisht në video identifikim pasi të filloni procesin e verifikimit në OneFor App.

Ne ju kërkojmë që Ju të ofroni informatat e nevojshme për të verifikuar identitetin tuaj. Ju pajtoheni të na ofroni Ne të dhënat e kërkuara, fotografi dhe informata. Këtu përfshihen dokumente që konfirmojnë vërtetësinë e informatave, vlefshmërinë e informatave dhe të dhënave të kërkuara.

Në rast se të dhënat personale që ju identifikojnë Ju ndryshojnë ose skadojnë, Ne ju kërkojmë që të na informoni Ne dhe të ndryshoni të dhënat në përputhje me rrethanat. Në rast se vlefshmëria e dokumentit që Ju keni përdorur për identifikim skadon, Ne ju kërkojmë të paraqisni dokumentet tuaja të përditësuara. Ne rezervojmë të drejtën për të bllokuar qasjen tuaj në OneFor App ose për të ndërprerë kontratën me Ju, në qoftë se Ju nuk përditësoni të dhënat tuaja. Nëse informatat tuaja të kontaktit ndryshojnë, Ne ju kërkojmë t'i përditësoni këto të dhëna në OneFor App.

Ne rezervojmë të drejtën të ju kërkojmë të konfirmoni të dhënat tuaja në intervale të rregullta. Pas regjistrimit dhe video identifikimit, Ne do të ju informojmë brenda 24 orëve nëse e kemi pranuar ofertën tuaj për të lidhur një kontratë për një llogari Në përputhje me legjislacionin në fuqi për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, hapja e çdo marrëdhënie me klientin, duke përfshirë një marrëdhënie të mbajtësit të kartelës, i nënshtrohet identifikimit të duhur nga Ne. Pas pranimi, Ju mund të shtoni fonde në llogarinë tuaj OneFor dhe më pas të kryeni transaksione. Nëse Ne ofrojmë shërbime tjera shtesë përtej atyre të përmendura më lart, Ju mund të përdorni këto shërbime ndaras duke përdorur funksionet përkatëse në OneFor App.

5. Shërbimet e OneFor

Me shërbimet e OneFor Ne kemi parasysh të gjitha shërbimet që ju vihen në dispozicion Ju, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përdorimin e OneFor, menaxhimin e llogarisë, lëshimin dhe administrimin e kartelës suaj të OneFor, lehtësimin e transfereve të parave, ekzekutimin e transaksioneve të pagesave (përfshirë transaksionet e pagesave përmes një karteje) dhe tërheqjet e parave të gatshme nga llogaria në OneFor.

OneFor App është kanali kryesor për ofrimin e shërbimeve tona për Ju. Ju merrni qasje në aplikacion duke u regjistruar për shërbimin tonë. Shërbimi i ofruar nga OneFor App varet nga (a) bashkëpunimi juaj dhe qëllimi dhe (b) lloji i informatave që Ju na i ofroni Ne.

Regjistrimi në aplikacionin tonë OneFor ju jep të drejtën vetëm Ju për të përdorur shërbimet tona, në përputhje me kushtet dhe rregullat e përgjithshme. Me përfundimin e përdorimit të shërbimeve tona, e drejta juaj për të përdorur OneFor App gjithashtu mbaron.

Edhe pse Ne vazhdimisht përpiqemi të sigurojmë përdorimin e pakufizuar dhe disponueshmërinë e shërbimeve të OneFor, Ne nuk ofrojmë ndonjë garanci sa i përket kësaj. Prandaj, ju pranoni që hyrja në shërbimet e OneFor mund të kufizohet përkohësisht për arsye teknike (p.sh. keqfunksionime, mirëmbajtje) ose për arsye përtej kontrollit tonë (p.sh. *forcë madhore*, faj i pales së tretë etj).

Ne do të ju informojmë në kohë nëse puna e mirëmbajtjes është e nevojshme dhe se për këtë arsye shërbimet e OneFor nuk janë të disponueshme. Ju mund të përdorni llogarinë tuaj OneFor dhe kartelën tuaj OneFor vetëm nëse keni bilanc të disponueshëm në llogarinë tuaj. Ju gjithmonë keni mundësinë të kontrolloni llogarinë dhe bilancin e kartelës tuaj në OneFor App.

Një deklaratë elektronike e përditësuar vazhdimisht e historikut tuaj të transaksioneve është në dispozicion 24 orë në 7 ditë në javë, duke vizituar OneFor App. Ju pajtoheni se këto janë procedura të arsyeshme për të pasur qasje në pasqyrat e kartelës dhe llogarisë tuaj. Ne ju inkurajojmë që të mbani faturat tuaja për të vërtetuar transaksionet e kartelës tuaj. Tutje, Ne ju inkurajojmë që të kontrolloni transaksionet e pagesave të paktën një herë në muaj. Në përputhje me ligjin në fuqi, të dhënat e transaksioneve të pagesave të krijuara ose të pranuar nga ne mund të përbëjnë prova të ekzistencës, shumës dhe kushteve të transaksioneve. Shërbimet e OneFor u nënshtrohen disa limiteve të caktuara që ekzistojnë për të ruajtur integritetin e shërbimit. Ne mund t'i rrisim ose zvogëlojmë këto limite në çdo kohë dhe të kërkojmë verifikim shtesë të identitetit dhe informatat për burimin e fondeve për të bërë përcaktime të tilla.

6. Llogaria OneFor

Llogaria OneFor do të thotë llogaria juaj e parave elektronike me Ne. Llogaria OneFor përdoret për të procesuar transaksione nga kartela juaj e lidhur si dhe për të kryer transaksione/pagesa të tilla si: pagesa të shërbimeve komunale, pagesa në llogari të tjera bankare të vendit apo pagesa të tjera për klientët e OneFor në çdo vend ku shërbimi i OneFor është i pranishëm. Për të hapur një llogari OneFor, ju duhet të jeni një person fizik dhe mbi moshën 18 vjeç.

Një llogari në OneFor mund të hapet edhe nga një person fizik nën moshën 18 vjeç, me kufizimet e parapara në pjesën Kushtet dhe Rregullat e Përgjithshme për Përdorimin e Shërbimeve Junior Wallet. Ju mund të merrni qasje në llogarinë OneFor Kosova vetëm nëse jeni rezident në Kosovë. Ju mund të hapni vetëm një llogari me ne.

Ne kemi të drejtë të refuzojmë aplikimin për të hapur një llogari në OneFor në bazë të informatave konfidenciale të disponueshme për Ne. Ne nuk jemi të detyruar të ju shpjegojmë arsyet e refuzimit.

Llogarinë tuaj në OneFor mund ta mbushni me fonde. Fondet që janë të ngarkuara në llogarinë tuaj nuk përbëjnë një depozitë. Bilanci në llogarinë tuaj nuk fiton ndonjë interes. Kur shtoni fonde në llogarinë tuaj, bilanci i ri do të jetë i disponueshëm në momentin që shuma shtohet në mënyrë efektive në llogarinë tuaj të OneFor.

Llogarinë tuaj OneFor mund ta mbushni vetëm në EURO. Nëse Ju filloni një transferim nga një llogari që mbahet në një valutë tjetër, transferi do të bëhet në EURO. Nëse valuta e transaksionit nuk korrespondon me valutën e llogarisë, shuma e transaksionit do të debitohet në valutën e

Ilogarisë, ku kursi i këmbimit i aplikuar nga lëshuesi dhe i vlefshëm në kohën e përpunimit të transaksionit mund të zbatohet me një shtesë deri në 1% .

Ne kemi të drejtë të debitojmë llogarinë OneFor me transaksione të bëra duke përdorur kartelën e OneFor dhe tarifat që bëhen pa pëlqim pasi të kemi marrë informatat në lidhje me transaksionin. Në kohën kur ekzekutohet një transaksion, Ne do të bllokojmë shumën e transaksionit dhe të gjitha tarifat përkatëse në llogarinë OneFor derisa të marrim informatat në lidhje me transaksionin.

Nëse informatat në lidhje me transaksionin nuk janë pranuar në kohën e duhur, llogaria do të zhbllokohet pa u hequr të drejtat e lartpërmendura.

Fondet në llogarinë tuaj OneFor mbahen në konfidencialitet nga Lëshuesi. Lëshuesi pajtohet të mbajë fondet e ngarkuara në llogarinë OneFor të ndara nga fondet e tjera të mbajtura prej tij, dhe të përdorë gjithë kujdesin e arsyeshëm në ruajtjen e fondeve të tilla.

Ju jeni i autorizuar të bëni pagesa vetëm nga llogaria juaj OneFor. Në mënyrë që të bëni një pagesë, duhet të na paraqisni konfirmimin përkatës të pagesës tek Ne, duke përdorur opsionin përkatës të transferimit bankar në OneFor App.

Emri juaj dhe numri i llogarisë do të plotësohen paraprakisht në konfirmim të pagesës, ju do të plotësoni shumën e pagesës në EURO, emrin dhe numrin e llogarisë së përfituesit, qëllimin e pagesës dhe informata të tjera që kërkohen në konfirmim të pagesës. Plotësimi i këtyre informatave është i nevojshëm për ekzekutimin e pagesës. Ne rezervojmë të drejtën për të shtyrë ose refuzua urdhërpagesën, nëse nuk jepni të gjitha informatat e nevojshme në mënyrë që Ne të mund të verifikojmë pajtueshmërinë me transaksionin.

Urdhërpagesa do të konfirmohet në mënyrë të pakthyeshme nga Ju në formën e specifikuar nëse është dërguar përmes OneFor App, duke përdorur mjetet e duhura të autenticitetit (vërtetësisë) me dy faktorë siç kërkohet.

Ne kemi të drejtë të refuzojmë ekzekutimin e një urdhërpagese në rastet e mëposhtme:

- Bilanci i llogarisë suaj është i pamjaftueshëm për të kryer urdhërpagesat përkatëse dhe/ose për të mbuluar kostot e pagesës;
- Detajet e urdhërpagesës nuk janë të mjaftueshme për verifikimin e pajtueshmërisë;
- Ju vendosët kërkesën për të anuluar pagesën e regjistruar nëse pagesa është në pritje në sistemet tona.

Si masë paraprake dhe për të mbrojtur interesat tuaja, Ne kemi të drejtë, pa detyrim, të kërkojmë konfirmim shtesë të pagesës (autorizim) nga Ju, nëse Ne dyshojmë në përpjekje për mashtrim me fondet tuaja gjatë përpunimit të pagesës apo nëse një transaksion i mashtrimit pas kontrollit mund të mos zbulohet. Ne kemi të drejtë të shtyjmë ekzekutimin e një pagese të tillë derisa Ju të konfirmoni pagesën në përputhje me kërkesat tuaja. Në këtë rast, Ne mund të refuzojmë të ekzekutojmë pagesën nëse nuk marrim një konfirmim nga Ju.

Ne do të ju informojmë Ju për një shtyrje të pagesës ose refuzimin për të ekzekutuar pagesën me anë të një njoftimi (p.sh. në OneFor App) sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se fundi i ditës së ardhshme të punës, përveç nëse veprimet ligjore të zbatueshme për Ne ndalojnë ofrimin e një informate të tillë.

Pagesat tuaja ndaj bankave të tjera ose ofruesve të pagesave do të përpunohen nga Ne në ditët zyrtare të punës së bankave, duke marrë parasysh afatin e pranimi dhe datën e vlefshme të

pagesave. Për ekzekutimin e një urdhërpagese, Ne zgjedhim metodën më të përshtatshme të ekzekutimit dhe sistemet më të përshtatshme të përpunimit. Nëse urdhërpagesa që dorëzuat është marrë nga Ne para afatit të fundit të pranimit të përcaktuar në listën e çmimeve, Ne do ta ekzekutojmë pagesën me datën e vlefshme të specifikuar në urdhër. Në këtë datë të vlefshme, Ne ia përcjellim shumën e pagesës përfituesit, bankës përfituese apo bankës ndërmjetësuese. Nëse Ne pranojmë urdhërpagesën që Ju dërguat pas afatit të pranimit të specifikuar në listën e çmimeve, Ne do ta përpunojmë atë ditën tjetër të punës. Ne kemi të drejtë, pa detyrim, të përpunojmë urdhërpagesën tuaj në të njëjtën ditë pune duke zgatur datën e vlefshme të pagesës për një ditë tjetër pune. Nëse data e vlefshme e deklaruar në listën e çmimeve është një festë publike e bankës korrespondente, bankës ndërmjetësuese, bankës pranuese apo sistemit të shlyerjes përmes të cilit do të ekzekutohet pagesa, Ne, banka korrespondente, banka ndërmjetësuese, banka pranuese, apo sistemi i shlyerjes mund të dërgojë urdhërpagesën tuaj të paraqitur në ditën tjetër të punës përmes së cilës do të kryhet pagesa. Nëse banka korrespondente, banka ndërmjetësuese, banka pranuese, apo sistemi i përpunimit përmes të cilit pagesa juaj do të bëhet në një bankë tjetër ndodhet në një zonë tjetër kohore, Ne nuk mund të garantojmë ekzekutimin në përputhje me dispozitat e listës së çmimeve. Nëse Ju kryeni transfere tek një ofrues tjetër, Ne nuk mund të garantojmë që shuma e pagesës do të i përcillet ofruesit të pagesës së përfituesit dhe do të kreditohet në llogarinë e përfituesit në kohën e duhur, nëse një ose më shumë banka ndërmjetëse/ofruesit e pagesave janë të përfshirë në ekzekutimin e pagesës.

Një pagesë e drejtuar tek Ju nga një ofrues tjetër pagese do të kreditohet në llogarinë tuaj në ditët e punës pas pranimit të një porosit nga banka ose ofruesi i pagesës së iniciuesit të pagesës në lidhje me pagesën e drejtuar tek Ju, me kusht që Ne të kemi pranuar të gjitha informatat e kërkuara për ekzekutimin e pagesës në përputhje me kërkesat tona. Ne kemi të drejtë të mos e kreditojmë pagesën drejtuar tek Ju dhe llogaria juaj nga një ofrues tjetër pagese, derisa të kemi marrë të gjitha konfirmimet përkatëse në përputhje me kërkesat tona që shuma e pagesës të jetë kredituar në llogarinë tonë të korrespondencës. Kur pagesa e drejtuar tek Ju nga një ofrues tjetër pagese kreditohet në llogarinë tuaj, Ne përcaktojmë datën e vlefshme të pagesës në përputhje me datën e vlefshme të specifikuar në urdhërpagesë. Nëse data e vlefshme e specifikuar në urdhërpagesë është para datës së përpunimit të pagesës nga Ne, Ne kemi të drejtë të vendosim ditën e punës para datës së përpunimit të pagesës si datën e vlefshme. Shuma e pagesës do të transferohet tek Ju në datën e vlefshme të pagesës së specifikuar nga Ne. Ne do të ju informojmë për datën e vlefshme të pagesës që ju kreditohet Ju në pasqyrën e llogarisë tuaj. Një pagesë drejtuar tek Ju konsiderohet se është ekzekutuar siç duhet, me kusht që të jetë ekzekutuar në përputhje me numrin e llogarisë tuaj në formatin e specifikuar në urdhërpagesë. Ne kemi të drejtë të kontrollojmë, pa detyrim, nëse numri i llogarisë i dhënë në urdhërpagesë përputhet me emrin tuaj dhe në rast të një mospërputhje përkatëse, Ne do të refuzojmë të ekzekutojmë pagesën ose të kërkojmë që informata të ndryshohet. Nëse fondet janë kredituar në llogarinë tuaj si rezultat i gabimit tonë, ne kemi të drejtë të debitojmë llogarinë me këto fonde pa pëlqim, me të cilën do t'ju informojmë Ju në përputhje me rrethanat në pasqyrën e llogarisë suaj.

Ju keni të drejtë të kërkonit një korrigjim apo anulim të urdhërpagesës së paraqitur tek Ne, duke na kontaktuar Ne përmes OneFor App ose përmes shërbimit të klientit. Sidoqoftë, Ne nuk garantojmë që urdhërpagesa do të korrigjohet ose anulohet. Ne garantojmë që urdhërpagesa juaj do të korrigjohet ose anulohet nëse ende nuk është kryer siç e keni kërkuar Ju. Nëse keni kërkuar korrigjimin ose anulimin e një urdhërpagese të ekzekutuar tashmë, Ne, për aq sa është e mundur, do të kontaktojmë bankën e përfituesit ose bankën ndërmjetësuese në mënyrë që të kërkojmë korrigjime dhe rimbursim në urdhërpagesën e ekzekutuar që Ju keni kërkuar. Në një rast të tillë, Ju mund të ngarkoheni me tarifë për koston e anulimit të pagesës.

Nëse Ju vëreni se fondet që nuk ju përkasin juve janë transferuar gabimisht në llogarinë e juaj atëherë jeni të obliguar që posa të mësoni për këtë fakt të na njoftoni Ne për këtë. Në raste të tilla, ju si përfitues i paautorizuar i fondeve të transferuara, do të privoheni nga e drejta për të disponuar fondet e transferuara dhe këto fonde duhet t'i dërgoni menjëherë në llogarinë elektronike të parav dhe pagesave të përcaktuara nga Ne.

Nëse fondet e disponueshme në llogarinë e juaj janë tashmë të pamjaftueshme për debitimin e fondeve të kredituara gabimisht, ju duhet të paguani shumën përkatëse të fondeve në llogarinë e caktuar nga Ne brenda 3 (tre) ditëve pas kërkesës së parashtruar nga Ne.

7. Kartela OneFor

Kartela OneFor është një kartelë debiti që do të lëshohet për Ju dhe është e lidhur me llogarinë i autorizim shtesë duke konfirmuar një transaksion të tillë me një kartelë me një fjalëkalim një here të marrë nga Ne. Ju pajtoheni që një konfirmim i transaksionit i bërë në përputhje me procedurat e mësipërme përbën pëlqimin tuaj të pakthyeshëm në lidhje me shumën dhe detajet e tjera të dhëna në dokument ose në ekranin e një ATM ose kartelë POS terminali.

Secilën herë që Ju përdorni kartelën tuaj OneFor, Ju na autorizoni Ne që të zvogëlojmë bilancin tuaj të disponueshëm me shumën e transaksionit, plus tarifat e zbatueshme dhe kurset e konvertimit të valutave të huaja. Ju nuk ju lejohet të tejkaloni bilancin tuaj të disponueshëm përmes një transaksioni individual ose një seri transaksionesh.

Ne normalisht marrim njoftim për autorizimin tuaj në formën e një porositë elektronike në përputhje me rregullat dhe procedurat e sistemit të pagesave (rrjeti Mastercard). Sapo që Ne kemi pranuar njoftimin për autorizimin tuaj për të kryer transaksionin, më tutje transaksioni nuk mund të ndalet ose anulohet. Sidoqoftë, në rrethana të caktuara, Ju mund të keni të drejtë për një rimbursim sipas rregullave të mosmarrëveshjes së kartelës dhe sipas rregullave të rrjetit Mastercard.

Në rrethana të caktuara, Ne mund të refuzojmë të kryejmë një transaksion me kartelë që Ju keni autorizuar. Këto rrethana përfshijnë, ndër të tjera:

- Në rast se Ne kemi një dyshim të arsyeshëm se siguria e kartelës suaj është komprometuar dhe për këtë Ne dyshojmë se ajo po përdoret në një mënyrë mashtruese ose të paautorizuar;
- Në rast se Ne pranojmë njoftim për transaksionin, ka fonde të pamjaftueshme në dispozicion për të mbuluar transaksionin dhe çdo tarifë përkatëse;
- Në rast se ka gabime, dështime (mekanike ose të tjera) ose refuzime nga tregtarët, përpunuesit e pagesave ose transaksionet e sistemeve të pagesave; ose Në rast se Ne jemi të detyruar ligjërisht që të bëjmë kështu.
- Në rast se Ne refuzojmë që të përfundojmë një transaksion, Ne do të ju njoftojmë sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur se transaksioni ishte refuzuar, dhe për cilat arsye, së bashku me procesin e korrigjimit të ndonjë gabimi faktik që dërgoj në refuzim, nëse është e zbatueshme.

Ne mund të pezullojmë (përkatësisht bllokojmë) përdorimin e kartelës suaj OneFor nëse kemi shqetësime të arsyeshme në lidhje me përdorimin e sigurt të kartelës suaj, ose në rast se Ne dyshojmë se kartela juaj po përdoret në një mënyrë mashtruese ose të paautorizuar. Ne do të junjoftojmë për një pezullim të tillë me anë të një njoftimi përmes OneFor App ose përmes email

dhe arsyet e pezullimit, përveç nëse kjo do të rrezikonte masat e duhura të sigurisë ose përndryshedo të ishte e paligjshme. Pezullimi do të hiqet sa më shpejt që arsyet për një pezullim të tillë të mos ekzistojnë më, dhe Ne më pas do t'ju informojmë Ju për heqjen e pezullimit menjëherë.

Për arsye të sigurisë, Ne do të vendosim kufijtë e pagesave për transaksionet e bëra me kartelën OneFor, përfshirë transaksionet në Internet (duke vendosur shumën maksimale të secilës pagesë individuale ose shumën maksimale për një periudhë të caktuar kohe). Ju keni mundësinë që i menaxhoni këto kufij përmes OneFor App.

Kartela juaj OneFor mund të bëhet joaktive, pas një periudhe të zgjatur të asnjë aktiviteti financiar të iniciuar nga Ju (që është, asnjë aktivitet tjetër përveç ndonjë kredie ose debiti të iniciuar nga Ne). Nëse kartela juaj është joaktive, Ne mund të bllokojmë transferet dalëse nga kartela juaj derisa të kontaktoni shërbimin e klientit për të ri-autorizuar transferime të tilla.

Në rrethana normale, nëse tentohet ndonjë pagesë që tejkalon fondet e disponueshme në llogari, transaksioni do të refuzohet. Në rrethana të caktuara, një transaksion mund të çojë llogarinë tuaj në një bilanc negativ - kjo do të ndodhë për shembull kur tregtari nuk ka arritur të kërkojë autorizim për transaksionin e kartelës. Në këto raste, me kusht që Ne jemi të kënaqur që Ju nuk e keni përdorur kartelën qëllimisht në mënyrën që do të rezultojë në një bilanc negativ të llogarisë, Ne do t'ju japim mbitërheqjen teknike në llogarinë tuaj. Mbitërheqja teknike do të jepet nga Ne në formën e mbitërheqjes jo të-lejueshme. Ne do të kemi të drejtë të japim në llogarinë tuaj mbitërheqjen teknike deri në shumën që do t'i shtohet bilancit të fondeve në dispozicion në llogari për të shlyer detyrimet tuaja të veçanta të pagesës.

Mbitërheqja teknike do të konsiderohet e pranuar në momentin e kryerjes së detyrimeve tuaja të pagesës. Mbitërheqja teknike do të shlyhet nga Ju menjëherë në ditën e origjinës të së njëjtës. Duke përdorur kredencialet ose duke nënshkruar regjistrin e transaksionit për një blerje, tërheqje parash ose para në avans, Ju na autorizoni Ne që të paguajmë shitësin me pakicë, tregtarin, bankën ose ofruesin e shërbimit, siç është e zbatueshme, për një transaksion. Ky autoritet nuk mund të tërhiqet pasi transaksioni të bëhet i pakthyeshëm. Regjistrat e transaksioneve të dërguara nga shitësi me pakicë, tregtari, banka ose ofruesi i shërbimeve, edhe në mungesë të një nënshkrimi me shkrim, mund të përdoren si dëshmi e transaksionit në përputhje me ligjin në fuqi.

Operatorët e ATM mund të vendosin kufij më të ulët të shumës së tërheqjes sesa ato të vendosura nga Ne. Po ashtu, operatorët e ATM (ose çdo rrjet i përdorur) mund të vlerësojnë tarifat e ndara nga ato të ngarkuara nga Ne, përfshirë tarifat për kërkesat për bilancin e kartelës edhe nëse Ju nuk kryeni një transferim fondesh.

Nëse Ju tërhiqni fonde nga një ATM që shpërndan një valutë tjetër të ndryshme nga ajo e vendit ku ndodhet ATM, operatori i ATM mund të konvertojë shumën që tërhiqet në valutën e tyre lokale përpara se ta ktheni atë në valutën që shpërndahet. Kjo mund të ndodhë edhe kur valuta që shpërndahet është e njëjtë me atë të kartës suaj. Shuma e debituar nga kartela juaj OneFor mund të jetë më e madhe se shumën që shpërndahet nga ATM. Jo të gjithë operatorët e ATM këshillojnë shumën që do të debitet nga karta juaj para se të tërhiqni para nga ATM-të e tyre. Kur kartela OneFor përdoret për të kryer një transaksion pagese në një valutë tjetër përveç EUR, do të zbatohet kursi i zbatueshëm i këmbimit. Përveç kësaj, një tarifë e konvertimit të valutës do të zbatohet gjithashtu siç përcaktohet në "Listën e çmimeve dhe shërbimeve".

8. Përdorimi i shërbimeve OneFor, autenticiteti, komunikimi i/ndryshimi i informatave, regjistrimi i bisedave telefonike dhe komunikimeve elektronike

I tërë komunikimi me Ju do të bëhet realizohet përmes OneFor App (veçanërisht në lidhje me ofrimin e pasqyrave bankare), përmes email si dhe mbështetjen tonë të klientit (telefon, bisedë, e-mail). Detajet tona të kontaktit janë të shënuara në faqen e internetit të OneFor Kosova.

Përdorimi i komunikimit mes nesh do të bazohet në pëlqimin e dhënë nga ju si dhe në rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave.

Ne dërgojmë porosi të shkurtra (Push/SMS) ne aplikacion, email apo në numrin e telefonit mobil të dhënë nga Ju. Juve ju kërkohet të mundësoni një shërbim të tillë kur regjistroheni për shërbimin tonë. Ju këshillojmë që t'i lexoni rregullisht këto porosi dhe të raportoni çdo gabim që mund të vëreni menjëherë.

Ne do të komunikojmë me Ju në gjuhën shqipe, çdo gjuhë tjetër që ju vihet në dispozicion Ju është mbi bazën e përpjekjeve më të mira. Kjo vlen edhe për këtë marrëveshje: për lehtësinë tuaj Ju mund t'i qaseni një versioni të përkthyer të marrëveshjes në një nga gjuhët e mbështetura nga aplikacioni ynë, megjithatë në rast të mosmarrëveshjes, mbizotëron versioni në gjuhën shqipe. Ju pranoni dhe pajtoheni që, në mënyrë që Ne të kryejmë shërbimet ndaj Juve, Ne kemi të drejtë të regjistrojmë dhe mbajmë regjistra të komunikimeve telefonike dhe elektronike me Ju, të gjitha në pajtim me rregulloret e zbatueshme të privatësisë. E drejta për të regjistruar dhe mbajtur të dhëna të komunikimeve të tilla nuk do të shkaktojë asnjë përgjegjësi për Ne. Këto të dhëna do të ruhen në afatet e përcaktuara me ligjin e zbatueshëm.

Ne kërkojmë nga Ju që të ofroni informatat e nevojshme për të verifikuar identitetin tuaj. Ju merrni përsipër të na ofroni Ne të dhënat dhe informatat e kërkuara, si dhe dokumentet që konfirmojnë vërtetësinë dhe vlefshmërinë e informatave dhe të dhënave të dhëna. Në rast se të dhënat personale që ju identifikojnë Ju, ndryshojnë ose skadojnë, Ne ju kërkojmë të na informoni dhe të ndryshoni të dhënat në përputhje me rrethanat. Në rast se vlefshmëria e dokumentit që Ju keni përdorur për identifikim skadon, Ne ju kërkojmë të paraqisni dokumentet tuaja të ripërtërira. Ne rezervojmë të drejtën për të bllokuar qasjen tuaj në llogarinë OneFor ose që të ndërpresim kontratën me Ju, në rast se Ju nuk i përditësoni të dhënat tuaja. Në rast se informatat e kontaktit të tuaj ndryshojnë, Ne ju kërkojmë të përditësoni këtë informatë në OneFor App. Ne rezervojmë të drejtën të ju kërkojmë Ju që të konfirmoni të dhënat tuaja në intervale të rregullta.

Ju nuk do të keni mundësinë që t'i ndryshoni vetë informatat e mëposhtme në llogarinë tuaj të përdoruesit: E-mail, numrin e telefonit mobil, adresën e regjistrimit. Ne do të verifikojmë çdo adresë e-mail, numrin të telefonit mobil ose detajet e adresës së regjistrimit të cilat janë ndryshuar.

Ne kërkojmë që Ju të njoftoni mbështetjen tonë për klientin për çdo ndryshim të informatave, p.sh. ndërrimi i mbiemrit (martesa).

Ju keni të drejtë të keni qasje dhe të përdorni OneFor App në distancë dhe të paraqisni aplikacione duke përdorur mjetet e autenticitetit (vërtetimit) që Ne kemi lëshuar në përputhje me procedurën që Ne kemi vendosur. Porositë që Ju na dërgoni Ne përmes OneFor App duke përdorur mjetet e autenticitetit janë detyruese për Ju dhe Ne, dhe kanë të njëjtën forcë ligjore si porositë që kanë një nënshkrim manual në bazë të Ligjit Nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet Besuara në Transaksionet Elektronike.

Ju keni të drejtë të keni qasje dhe të përdorni OneFor App në distancë dhe të paraqisni aplikacione duke përdorur mjetet e autenticitetit (vërtetimit) që Ne kemi lëshuar në përputhje me procedurën që Ne kemi vendosur. Porositë që Ju na dërgoni Ne përmes OneFor App duke përdorur mjetet e autenticitetit janë detyruese për Ju dhe Ne, dhe kanë të njëjtën forcë ligjore si porositë që kanë një nënshkrim manual në bazë të Ligjit Nr. 08/L-022 për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike.

I tërë komunikimi zhvillohet ndërmjet Ju dhe Ne. Kjo përfshin por nuk kufizohet në deklarata apo njoftime në lidhje me marrëdhënien tuaj kontraktuale me Lëshuesin. Sa i përket kësaj, Ne jemi ndërmjetës që ofrojmë dhe pranojmë deklarata për Lëshuesin. Ju po ashtu duhet të dërgoni tek Ne çdo njoftim për të ndërprerë llogarinë OneFor ose kontratën e përdorimit të kartelës së debitit. OneFor më pastaj do të informojë Lëshuesin për këtë në afatin prej (5) ditësh.

9. Kushtet e Programit Referral

Programi i referimit është i bazuar në vlerësimin që Ne kemi tek Ju. Programi ynë i referimit është krijuar për të shprehur mirënjohjen tonë duke ofruar përfitime dhe shpërblime ekskluzive si për Ju ashtu edhe për klientët e rinj që ju referoni.

Për t'u kualifikuar për shpërblime, referimet duhet të plotësojnë kriteret specifike të përshkruara si në vijim:

Referimet duhet të jenë klientë të rinj që nuk janë regjistruar më parë në platformën tonë. Vetë-referimet, llogaritë mashtruese ose të kopjuara dhe referimet e postës së padëshiruar nuk do të kualifikohen për shpërblime.

Mund të ketë kufizime në numrin e referimeve që mund të bëni brenda një periudhe të caktuar për të siguruar drejtësi dhe për të parandaluar abuzimin.

Ne rezervojmë të drejtën për të modifikuar ose përfunduar programin e referimit në çdo kohë. Çdo ndryshim do t'u komunikohet pjesëmarrësve nëpërmjet emailit, njoftimeve të faqes në internet ose kanaleve të tjera të përshtatshme.

Shpërblimet e referimit janë të destinuara vetëm për përdorim personal dhe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale ose përfitime monetare.

Për mënyrën se si mund të bëheni pjesë e këtij programi si dhe mundësitë për t'u shpërblyer mund të vizitoni këtë [link](#).

10. Ankesat

Nëse Ju keni nevojë për informata shtesë apo nuk jeni të kënaqur me ndonjë element të shërbimit që pranoi, atëherë Ju mund të paraqisni ankesën tuaj përmes kanaleve në dispozicion, siç është e-mail adresa zyrtare, qendrën e thirrjeve të kujdesit për klient apo përmes aplikacionit OneFor.

Ne do t'i përgjigjemi ankesës tuaj, në e-mail tuaj të regjistruar. Një përgjigje e tillë adreson të gjitha pikat e ngritura, brenda një afati të duhur kohor dhe më së voni brenda tre (3) ditëve të punës nga pranimi i ankesës. Në situata të jashtëzakonshme, nëse përgjigja nuk mund të jepet brenda tre (3) ditëve të punës për arsye përtej kontrollit tonë, Ne do t'ju mbajmë Ju të informuar duke treguar qartë arsyet e një vonese në përgjigjen e ankesës, dhe duke specifikuar afatin deri në të cilin do të merrni përgjigjen përfundimtare.

Në rast se Ju nuk jeni të kënaqur me përgjigjen tonë, Ju keni të drejtë t'i drejtoheni Bankës Qendrore të Kosovës si në vijim:

- T'i adresoheni përmes postës në adresën: Rr. Garibaldi nr 33 Prishtinë, Kosovë.

- T'i drejtoheni me ankesë në linkun: <https://bqk-kos.org/ankesat/>
- T'i telefononi në numrin: 038 222 055

Në rast të dështimit për të zgjidhur një mosmarrëveshje në mënyrë miqësore ose me metoda të tjera jashtëgjyqësore të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga gjykata kompetente sipas ligjit të zbatueshëm.

11. Mbrojtja e të dhënave dhe rikthimi i të dhënave

Me hyrjen në këtë Marrëveshje, Ju na ofroni Ne dhe Lëshuesit pëlqimin tuaj paraprak të shprehur për të mbledhur, përdorur dhe përpunuar informatat tuaja personale dhe zbulimin e informatave për palët e treta, për të përmbushur detyrimet e saj sipas marrëveshjes dhe siç përcaktohet në politikën e privatësisë në përputhje me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Me përdorimin e kartelës OneFor, Ju pranoni t'i jepni Lëshuesit, përpunuesit dhe bashkëpunëtorëve të tyre të drejtën për të mbledhur informacione rreth Ju, për qëllimet e administrimit të shërbimit të kartelës, përpunimin e transaksioneve të kryera duke përdorur shërbimin, mirëmbajtjen e rregullt të llogarisë dhe qëllime të tjera siç përcaktohet në politikën e privatësisë.

Ndërsa Ne, rezervojmë të drejtën për të përpunuar dhe ruajtur të dhëna në vendet e Bashkimit Evropian, Ne do ta bëjmë këtë vetëm në pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ne marrim përsipër të kemi masat e duhura për të mbrojtur të dhënat tuaja dhe të sigurojmë se Ne do të përpunojmë të dhënat personale të përdoruesve tonë vetëm nëse Ne kemi leje ligjore, apo nëse Ju keni dhënë pëlqimin tuaj. Ju do të gjeni detaje rreth mënyrës se si Ne i trajtojmë të dhënat personale, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e të dhënave në politikën tonë të privatësisë në këtë [link](#).

Të dhënat transmetohen përmes një lidhje të sigurt dhe të koduar në Internet.

Ju mund t'i rishikoni të dhënat tuaja personale në OneFor App në çdo kohë. Ju gjithashtu keni të drejtë të kërkonti dhe të merrni informata në çdo kohë në lidhje me ndonjë nga të dhënat tuaja personale që mund të ruhen, burimin e tyre, pranuesit e të dhënave të tilla dhe pse po ruhen. Ne kemi të drejtë të regjistrojmë dhe mbajmë të gjitha të dhënat tuaja dhe komunikimin me Ju, pa njoftim paraprak, dhe do të zgjedhim në mënyrë të njëanshme mjetet teknike për regjistrimin e të njëjtave. Ne do të regjistrojmë dhe mbajmë të gjitha të dhënat në pajtim me kërkesat e akteve ligjore të zbatueshme dhe politikën e mbrojtjes së të dhënave. Ju do të pajtoheni që Ne kemi të drejtë t'i përdorim këto të dhëna si dëshmi për mbrojtjen e interesave tona në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe në gjykatë.

Në rast se një autoritet shtetëror, sikurse organet e ndjekjes, gjykatat apo autoriteti përkatës tatimorë ërkon informata në lidhje me llogarinë tuaj, Ne jemi të detyruar të zbulojmë informatat për Ju dhe llogarinë (të) tuaj(a) me autoritetin përkatës pa pasur nevojë për ndonjë pëlqim të tillë nga ana juaj, bazuar në nenin 22 të Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nëse një autoritet i tillë kërkon më shumë informata, Ne do t'ju qasemi Ju, dhe presim që Ju të jepni informatat e kërkuara menjëherë. Nëse Ju nuk e bëni këtë, Ju pranoni që Ne mund të pezullojmë ose mbyllim llogarinë tuaj, ose, nëse ligji ose rregullorja na kërkon Ne që ta bëjmë këtë, që Ne mund të mbajmë pjesë të disa pagesave të

pranuara në llogarinë tuaj dhe të kalojmë fondet e mbajtura autoriteteve përkatëse tatimore apo autoriteteve tjera shtetërore.

Ne do të mbajmë të dhënat tuaja të ruajtura pasi që kjo marrëveshje të jetë ndërprerë në pajtim me kërkesat ligjore. OneFor App mund të merret nga platformat e shitjeve të cilat operohen nga palë të treta ("dyqanet online të aplikacioneve").

OneFor App mund të merret vetëm nëse Ju jeni regjistruar së pari në dyqanin përkatës të aplikacioneve. Ne nuk kemi asnjë ndikim në mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale nga kompania e palës së tretë e cila operon dyqanin e aplikacioneve që Ju përdorni. Deri më tani, vetëm kjo kompani operuese e palëve të treta është kontrolluesi ekskluziv.

12. Detyrimi si përdorues

Ju duhet të siguroheni që të dhënat tuaja të qasjes në shërbimet OneFor janë të mbajtura sekret dhe të sigurta. Kjo do të thotë që Ju duhet të mbani të dhënat që nevojiten për të pasur qasje në shërbimet OneFor, nuk duhet të zbuloni këtë informatë, nuk duhet të lejoni ose të mundësoni ndonjë palë të tretë të marrë këtë informatë, dhe duhet të ndërmerrni çdo veprim të nevojshëm për të siguruar që informata e tillë të mbetet e fshehtë, p.sh. duke krijuar dhe ndryshuar rregullisht një fjalëkalim të sigurt i përbërë nga shifra, shkronja dhe karaktere speciale. Ju duhet të siguroheni që telefoni juaj mobil mbahet i sigurt dhe se nuk mund të përdoret nga palët e treta.

Ju mund të konfiguroni vetëm lidhjen teknike për shërbimet OneFor duke përdorur kanalet e qasjes (aplikacionin) për të cilat Ju jeni informuar nga Ne.

Ju duhet të siguroheni që e-mail (posta elektronike) mund të dërgohen dhe pranohen në adresën e postës elektronike që Ju ofroni nga momenti i regjistrimit.

Ju duhet të na informoni Ne pa vonesë nëse Ju zbuloni se të dhënat tuaja të qasjes janë humbur, vjedhur, keqpërdorur ose përdorur ndryshe pa autorizimin tuaj. Ju po ashtu duhet të raportoni çdo vjedhje ose keqpërdorim në polici, në kohë. Ju gjithashtu duhet të na informoni Ne në kohë nëse Ju dyshoni se ndonjë person tjetër ka marrë ose ka gjetur informata në lidhje me të dhënat tuaja të qasjes pa autorizimin tuaj, apo është duke i përdorur të dhënat tuaja të qasjes. Kur raportoni humbjen, vjedhjen, ose komprometimin e kartelës suaj OneFor, kredencialet apo përdorimin e paautorizuar të kartelës ose llogarisë suaj, Ju duhet të na ofroni Ne informata të sakta dhe të plota, përfshirë dhe verifikimin e identitetit tuaj, kredencialet tuaja të plota (përveç PIN-it tuaj), informatat për transaksionin, rrethanat që kanë rezultuar në humbje, vjedhje ose komprometim të kartelës ose kredencialeve tuaja, dhe ndihmoni për të siguruar që kartela apo llogaria të çaktivizohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Ne mund të kërkojmë deklarata me shkrim dhe vërtetime nga Ju.

Ju duhet të merrni masat paraprake përkatëse për të mbështetur të dhënat dhe përmbajtjen e futur, të ngarkuar dhe të ruajtur nga Ju kur përdorni shërbimet OneFor në intervale të rregullta dhe duhet të bëni kopjet tuaja mbështetëse për të mundësuar rivendosjen e të dhënave dhe informatave të cilat ishin humbur. Sulmet ndaj funksionalitetit të shërbimeve OneFor, siç janë dërgimi masiv i e-mail (postave elektronike (SPAM)), përpjekjet për të hakuar shërbimet, sulmet e forcës brutale, përdorimi ose dërgimi i spyware, viruseve janë të ndaluara dhe përdorimi i tyre mund të shërben si bazë në shkëputjen e kontratës.

Porositë e të gjitha llojeve duhet të kenë përmbajtje pa mëdyshje të njohur. Porositë të cilat nuk janë formuluar pa mëdyshje, mund të ketë pyetje për to dhe të rezultojnë në vonesa. Ju duhet të siguroheni në veçanti që informatat që ofroni në porosi janë të sakta dhe të plota, duke përfshirë por jo kufizuar në numrin e llogarisë OneFor.

Në asnjë rrethanë Ju nuk mund të përdorni kartelën tuaj OneFor dhe llogarinë OneFor: (1) në shkelje të ligjeve apo rregulloreve në zbatim, duke përfshirë ato që rregullojnë shërbimet financiare; (2) në shkelje të kësaj marrëveshjeje; (3) në një mënyrë që shkel privatësinë ose të drejtat pronësore të një tjetri, përfshirë spam, phishing ose kërkesa të padëshiruara; (4) për të kryer veprime të paligjshme, duke përfshirë bixhozin e paligjshëm dhe veprimet që përfshijnë mallra të vjedhura ose substanca të paligjshme; apo (5) për të kryer transaksione që përfshijnë transferimin e fondeve për qëllime të paligjshme ose të bëra për të fshehur burimin e fondeve të tilla ("pastrimi i parave").

13. Shpenzimet

Tarifat për përdorimin e shërbimeve OneFor, përfshirë shumën e pagesave, që tejkalojnë tarifat e pajtuara për shërbimin kryesor, janë të detajuara në "Listën e çmimeve dhe shërbimeve" në dispozicion në faqen e internetit të OneFor [këtu](#). Përveç nëse Ne jemi pajtuar ndryshe, tarifat e deklaruar në "Listën e çmimeve dhe shërbimeve" zbatohen për të gjitha shërbimet kryesore të renditura.

Shumat e deklaruar në "Listën e çmimeve dhe shërbimeve" përfshijnë tatimin mbi vlerën e shtuar.

Ne do të kemi të drejtë të ndryshojmë në mënyrë të njëanshme "Listën e çmimeve dhe shërbimeve", duke dhënë një njoftim mbi ndryshimet e tilla një muaj më herët se "Lista e re e çmimeve dhe shërbimeve" të bëhet efektive.

Përveç nëse Ne jemi pajtuar ndryshe, ne do të debitojmë tarifat nga Ju drejtpërdrejtë. Ju na autorizoni Ne të debitojmë tarifat nga llogaria juaj OneFor.

Nuk do të kërkohet nga Ju që të paguani asnjë pagesë, shpenzim apo tarifë drejtpërdrejtë tek Lëshuesi për përdorimin kontraktual të llogarisë OneFor dhe kartelës së debitit.

14. Afati dhe ndërprerja

Kontrata për përdorimin e shërbimeve OneFor bëhet efektive në datën që Ju regjistroheni tek Ne dhe lidhet për një periudhë të pakufizuar. Nëse pjesë të shërbimeve OneFor, të cilat ju i kenirezervuar veçmas përmes OneFor App, kanë një afat tjetër, ju do të informoheni për këtë gjatë procesit përkatës të rezervimit.

Ju mund të na dërgoni Ne një e-mail për të ndërprerë kontratën në çdo kohë, dhe me këtë të mbyllni llogarinë tuaj OneFor dhe llogarinë e kartelës. Ju mund të shlyeni bilancin tuaj të disponueshëm para mbylljes efektive të llogarisë. Ne pastaj do të fshijmë llogarinë tuaj të përdoruesit. Çdo e dhënë që nuk është mbështetur kur llogaria ndërpritet do të humbet pasi që Ne fshijmë plotësisht llogarinë tuaj të përdoruesit. Ne do të ju informojmë Ju për këtë para se të dhënat tuaja të fshihen. Ne mund të dërgojmë njoftim me shkrim ose e-mail dy (2) muaj përpara për të ndërprerë kontratën e përdorimit me Ju. Kontrata po ashtu mund të ndërpritet pa njoftim nga secila palë për një shkak të mirë. Një shkak i mirë që do të na lejojë Ne të ndërpresim pa njoftim do të ishte nëse do të ishte e paarsyeshme të presim që kjo kontratë të vazhdojë edhe sa i përket interesave tuaja legjitime.

Një shkak i mirë do të përfshinte gjithashtu, por nuk do të kufizohej në një shkelje të detyrimit të përshkruar ndërmjet Ju dhe Lëshuesit.

Ne dhe Ju nuk do të mbajnë përgjegjësi për mos përmbushjen ose përmbushjen e pamjaftueshme të detyrimeve, ose për çdo mospërputhje me Marrëveshjen, nëse një mos përmbushje e tillë ose e papërshtatshme është shkaktuar nga forca madhore (p.sh. katastrofat natyrore, lufta, bllokada e kushteve luftarake, embargot, trazirat, kufizimet qeveritare, trazirat e punës, rrënojat, epidemitë, karantina, zjarri, përmbytja, tërmeti, shpërthimi, çdo ndryshim i paparashikuar i rrethanave ose çdo shkak tjetër jashtë kontrollit të arsyeshëm të tij);

Ju do të na njoftoni Ne për forcën madhore në me email ose me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike pas ditës së shfaqjes së rrethanave të tilla.

Ne do të ju njoftojmë Ju për rrethanat e forcës madhore në njërin nga metodat e komunikimit për të cilat jemi pajtuar t'i përdorim së bashku.

15. E drejta e tërheqjes për klientët dhe formulari i shembullit të tërheqjes

Nëse Ju jeni klient, mund të anuloni deklaratën tuaj kontraktuale kur regjistroheni për shërbimet e OneFor sipas kushteve të mëposhtme:

E drejta për tërheqje

Ju keni të drejtë të tërhiqeni nga shërbimi OneFor brenda 14 ditëve pa dhënë ndonjë arsye. Periudha e tërheqjes do të skadojë pas 14 ditësh nga dita e përfundimit të regjistrimit. Për të ushtruar të drejtën e tërheqjes, Ju duhet të na informoni Ne për vendimin tuaj për t'u tërhequr nga shërbimi OneFor me një deklaratë të qartë (p.sh. një e-mail). Ju mund të përdorni formularin e shembullit të tërheqjes si më poshtë, por nuk është i detyrueshëm.

Për të plotësuar afatin e tërheqjes, mjafton që Ju të dërgoni komunikimin tuaj në lidhje me ushtrimin tuaj të së drejtës për tërheqje para se të ketë skaduar periudha e tërheqjes.

Efektet e tërheqjes

Nëse Ju tërhiqeni nga shërbimi OneFor, Ne do të ju rimbursojmë Ju të gjitha pagesat e marra nga Ju, përfshirë kostot e dërgesës (me përjashtim të kostove shtesë që rezultojnë nga zgjedhja juaj e një lloji të dërgesës përveç llojit më pak të shtrenjtë të dërgesës standard të ofruara nga Ne), pa vonesa të panevojshme dhe në çdo rast jo më vonë se 14 ditë nga dita në të cilën Ne jemi të informuar në lidhje me vendimin tuaj për të ju tërhequr nga shërbimi OneFor. Ne do të kryejmë një rimbursim të tillë duke përdorur të njëjtat mjete të pagesës që i keni përdorur Ju për transaksionin fillestar, përveç nëse Ju jeni pajtuar shprehimisht ndryshe; në çdo rast, Ju nuk do të pësoni asnjë tarifë si rezultat i rimbursimit të tillë.

Nëse Ju keni kërkuar të filloni kryerjen e shërbimeve gjatë periudhës së tërheqjes, Ju do të na paguani Ne një shumë që është në proporcion me atë që iu është ofruar derisa Ju të na keni komunikuar Ne tërheqjen tuaj nga shërbimi OneFor, në krahasim me mbulimin e plotë të shërbimit OneFor.

Nëse Ne ju ofrojmë Ju shërbime të caktuara të OneFor menjëherë pas regjistrimit, e drejta juaj për tërheqje skadon nëse Ju na keni dhënë Ne të dyja; (i) pëlqimin tuaj eksplisit si dhe (ii) keni

konfirmuar njohurinë tuaj se Ju hiqni dorë nga e drejta juaj për tërheqje, nëse Ne e përmbushim plotësisht shërbimin. E drejta juaj për t'u tërhequr nga shërbimi OneFor skadon në rastin e një kontrate për ofrimin e përmbajtjes dixhitale që nuk është në një bartës të të dhënave fizike, edhe nëse Ne kemi filluar të zbatojmë shërbimin pasi Ju shprehimisht jeni pajtuar që Ne do të fillojmë të zbatojmë shërbimin para përfundimit të periudhës së tërheqjes, dhe Ju keni konfirmuar se Ju jeni të vetëdijshëm se Ju do të hiqni dorë nga e drejta juaj për t'u tërhequr duke dhënë pëlqimin tuaj kur fillon zbatimi i shërbimit. Ne do t'i theksojmë këto pika për Ju ndaras në lidhje me shërbimet përkatëse të OneFor.

Formulari i shembullit të tërheqjes (Nëse Ju doni që të tërhiqeni nga kontrata, ju lutem plotësoni këtë formular dhe dërgojeni prapa)

Për: OneFor Kosova SH.P.K, Tahir Zajmi nr. 86, 10 000 Prishtinë, Kosovë
[e-mail adresa: support@onefor.com]

- Unë/Ne (*) me këtë njoftoj/më se Unë/Ne (*) tërhiqem/i nga kontrata ime/jonë (*)
Për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme (*),
- Porositur më (*)/pranuar më (*),
- Emri i klientit (ëve), • Adresa e klientit (ëve),
- Nënshkrimi i klientit (ëve) (vetëm nëse ky formular është i paraqitur në document),
- Data
- _____
- (*) Fshijeni sipas rastit.

16. Kufizimi i përgjegjësisë, nuk ka garanci

Ju nuk do të keni të drejtë në kërkesa për dëme. Ky mohim nuk do të zbatohet ndaj kërkesave për dëme ndaj Ne që dalin nga lëndimi për jetë, gjymtyrë apo shëndet, një shkelje thelbësore e detyrimeve kontraktuale (detyrime materiale) apo përgjegjësi për ndonjë qëllim tjetër ose shkelje të madhe neglizhence të detyrimit nga një palë, përfaqësuesit tanë ligjorë apo agjentët e deleguar.

Detyrimet thelbësore kontraktuale janë ato plotësimi i të cilave është i nevojshëm që të arrihet synimi i kontratës.

Në nivelin e lejuar nga ligji, Ne nuk do të jemi përgjegjës për ndonjë humbje apo shpenzime tjera shtesë që Ju i pësoni si rrjedhë e suspendimit të pagesës apo refuzimit për të ekzekutuar pagesën e specifikuar në këtë kontratë. Ne nuk jemi përgjegjës sa i përket një urdhërpagese të pa ekzekutuar apo të ekzekutuar gabim, nëse ekzekutimi i duhur i së njëjtës pengohet nga aktet ligjore apo kërkesat tjera rregullatore që zbatohen ndaj Ne.

Në nivelin e lejuar nga ligji, Ne nuk jemi përgjegjës për humbjet apo shpenzimet tjera shtesë që Ju mund të i pësoni si rezultat i një urdhërpagese të pa ekzekutuar apo ekzekutim jo të duhur, nëse numri i llogarisë së përfuturit të specifikuar në urdhërpagesën tuaj që është ruajtur në llogarinë e OneFor apo ndonjë format tjetër, përfshirë edhe numrin e llogarisë së pasaktë apo të pavlefshme, nuk përputhet me ndonjë detaj tjetër të dhënë të pagesës, edhe nëse detajet e dhëna në urdhërpagesën tuaj janë të pasakta apo të pakompletuara.

Nëse detyrimet thelbësore kontraktuale janë shkelur, në nivelin e lejuar nga ligji, Ne do të jemi përgjegjës vetëm për humbjet e parashikuara tipike për llojin e kontratës të përfshirë ku humbje të tilla janë rezultat i neglizhencës së thjeshtë, përveç se për kërkesat për dëme nga të cilat përfitoni Ju bazuar në lëndime për jetën, gjymtyrë apo shëndet.

Kufizimet e deklaruar po ashtu do të zbatohen ndaj përfaqësuesve tanë ligjorë dhe agjentëve të deleguar nëse kërkesat do të hapen ndaj tyre drejtpërdrejtë.

Kufizimi i deklaruar i përgjegjësisë nuk do të zbatohet nëse Ne me mashttrim kemi fshehur defektin ose kemi pranuar një garanci për cilësinë e artikullit. E njëjta do të zbatohet nëse Ne kemi hyrë në një marrëveshje mbi cilësinë e artikullit.

Përveç sa përcaktohet në këtë marrëveshje, Ne nuk bëjmë asnjë përfaqësim ose garanci sa i përket shërbimeve të ofruara.

17. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e biznesit

Ne do të kemi të drejtë që t'i ndryshojmë kushtet dhe rregullat e biznesit tonë në çdo kohë. Ne do t'ju ofrojmë Ju çdo ndryshim të kushteve dhe rregullave të biznesit me e-mail brenda dy (2) muajve më së voni nga koha e propozuar në të cilën ndryshimet do të hyjnë në fuqi. Ju ose mund të pajtoheni ose t'i refuzoni ndryshimet në kushte dhe rregullat e biznesit para datës në të cilën është propozuar që ndryshime të tilla të hyjnë në fuqi. Në rast se refuzoni ndryshimet në kushtet dhe rregullat e përgjithshme, atëherë Ju mund të ndaloni së përdoruri shërbimet tona. Do të konsiderohet se Ju keni dhënë pëlqimin nëse Ju nuk njoftoni refuzimin tuaj para datës në të cilën është propozuar që ndryshime të tilla të hyjnë në fuqi. Ne do t'i bëjmë referencë të veçantë rëndësisë së pëlqimit tuaj në ofertën tonë.

18. Ligji qeverisës

Kushtet e kësaj marrëveshjeje do të rregullohen dhe interpretohen në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe gjykatat e Kosovës do të merren me çdo procedurë ligjore ndërmjet nesh.

Kjo marrëveshje përbën të gjithë marrëveshjen midis Ju dhe Ne në lidhje me shërbimet e OneFor. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje përcaktohet të jetë e pazbatueshme sipas ligjit në fuqi, dispozitat e tjera të kësaj marrëveshjeje do të mbesin të vlefshme dhe të zbatueshme.

Një dështim nga Ne për të zbatuar kryerjen e ndonjë dispozite të kësaj marrëveshjeje nuk do të përbëjë në asnjë mënyrë heqje dorë nga Ne nga e drejta jonë për të zbatuar më pas një dispozitë të tillë ose ndonjë dispozitë tjetër të kësaj marrëveshjeje. Ato dispozita të kësaj marrëveshjeje që synojnë t'i mbijetojnë çdo ndërprerje ose anulim të kësaj Marrëveshjeje do të mbesin në fuqi pas ndonjë ndërprerje ose anulimi të tillë.